

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Breshëri plumbash ndaj një makine në Mat, autorët djegin automjetin e tyre
ADRESA	https://lapsi.al/bresheri-plumbash-ndaj-nje-makine-ne-mat-autoret-djegin-automjetin-e-ty-re-i1093584
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 08:28:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 08:23:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	57caea03f8a53a046e0914bbb29e8a699a374c8b1f6bf83094cb3ee14eccba43
TEKSTI	bfef8356053ff6963c0e30dbdc5e298ade4246bc21e651735f2d373585056ea2
PAMJA	70f5a1b0e8dc2e6f87643b0de94679eded6e155eef5b3f79d27c043d3e43928b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d77bb212c50ce752c558a044fb477cab86cb490788802247ab9bdeeeef3d0997
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4dbb247c3ea631ff8f2707e6b1f894f950e04cf248d4447a7ba057e4086fe8b1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d77bb212c50ce752c558a044fb477cab86cb490788802247ab9bdeeeef3d0997>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Breshëri plumbash ndaj një makine në Mat, autorët djegin automjetin e tyre

L LAPS1.AL • 13 SEPTEMBER 2026



FOTO ILUSTRUESE

Policia e Matit njofton se në datë 12 shtator rreth orës 23:10, në fshatin Urakë, Njësia Administrative Rukaj, persona ende të pidentifikuar kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të automjetit tip "Audi", në pronësi të shtetases S. Ll. (bashkëshortja e shtetasi A. Ll.), i parkuar në oborrin e banesës.

"Nga të shtënat janë shkaktuar dëmtime materiale vetëm në automjetin tip "Audi". Shërbimet e Policisë, me marrjen e njoftimit, shkuan menjëherë në vendngjarje dhe, në bashkëpunim me DVP Dibër, ngritën pika kontrolli. Ndërkohë, në vendngjarje shkoi grupi hetimor.

Shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit të territorit, rreth 2 kilometra larg nga vendi i ngjarjes, në aksin rrugor Rrëshen-Burrel, kanë konstatuar të djegur një automjet tip "Golf V". Gjatë këqyrjes së automjetit, në brendësi të tij janë gjetur dy armë zjarri kallashnikov, të djegura pjesërisht, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Nga verifikimet e kryera rezulton se automjeti tip "Golf", i konstatuar i djegur, ishte shpallur në kërkim nga DVP Elbasan më datë 31.07.2025, pasi kishte bërë kallëzim pronari i tij, shtetasi K. R., banues në Përrenjas, se i kishin vjedhur këtë automjet.

Shërbimet e Policisë po vijojnë kontrollet në zonën ku mund të kenë lëvizur autorët e dyshuar dhe po bashkëpunohet me DVP Tiranë, Lezhë e Kukës. *Grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, vijon intensivisht veprimet me qëllim zbardhjen e rrethanave, sigurimin e provave që do të çojnë në identifikimin dhe kapjen e autorëve*" - thuhet në njoftimin e policisë. /LAPSI.al

ide



Ortaku besprerë i Ron Yeffetit
Andi Bushati



Insistimi tek krimi, arësyeja përse kryeministri Rama duhet të dorëhiqet
Blendi Kajsiu

MOTITIRANA

23°C

KËMBIMIEURO

91.94

aktuale

15:53

Diaspora zbarkon në Tiranë për protestën e 105-të, shqiptarët udhëtojnë prej tri ditësh drejt kryeqytetit



22:36
PAMJET/ Mali i Zi nuk e lë karvanin e diasporës të futet në Shqipëri, i çon në Kosovë



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



Të keshilluara



'PISA 2025': Pasqyra e deformuar e suksesit të qeverisë me arsimin

Rritja e klasifikimit të Shqipërisë në rezultatet e testimit ndërkombëtar, PISA 2025, u bazua mbi një kampion jogjithpërfshirës të shkollave, duke ndikuar në rezultate dhe shmangur një pasqyrim real të nivelit të arsimit në vend.



Pas pak mblidhet Kuvendi i Kosovës/ PDK refuzon ftesën e LVV: Shihemi në Kushtetuese!

Seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës pritet të vazhdojë sot, ndërsa në rend të ditës është zgjedhja e n.s...



Të shtëna me armë zjarri në drejtim të një automjeti, gjendet e djegur edhe një makinë




Dita e 106-të e protestës, diaspora zbret sërish në shesh, paralajmërohet revoltë masive

Protesta qytetare në Tiranë shënon sot ditën e 106-të të revoltës qytetare kundër klasës politike. Ditën e sh...



Protesta qytetare në Tiranë/ Associated Press: Lëvizje më e gjerë antiqeveritare, që kërkon dorëheqjen e Edi Ramës

Protesta qytetare në Tiranë prej 105 ditësh vijon të tërheqë vëmendjen e mediave të huaja. Protestuesit dolën s'eu...



Pse i kemi çmimet kaq të shtrenjta?! TVSH e ushqimeve, ndër më të lartat në Europë

Shqipëria po përballlet me çmime ushqimore më të larta se mesatarja europiane, ndërsa të ardhurat për frymë mbete...



Gjyqtari i GJKKO: Rama mund të ketë përgjegjësi penale për mosekzekutimin e vendimit të pagave të magjistratëve



Kartoni i zi mbërrin në futboll, ja si funksionon: nuk do të përdoret për futbollistët



Qarkullonte me armë, arrestohet nipi i Lefter Kokës



E bujshme, Arteta e ka sabotuar qëllimisht Arsenal, duke shkaktuar edhe vonesa në fluturime: në Napoli funksionoi



Shpërthim me tritol në oborrin e një banese pranë bashkisë Shkodër



Pas mbylljes së fjalimeve protestuesit rrethojnë Kryeministrinë: Bashkohuni me ne

Pas përfundimit të fjalimeve para Kryeministrisë, protestuesit njoftuan se nuk do të vijojnë me marshim, por do të qëndrojnë...



Situata me zjarret në vend, 3 vatra mbeten aktive

11 vatra zjarri janë regjistruar gjatë ditës së sotme në territorin e Shqipërisë, ndërsa 3 prej tyre vijojnë të qëndrojnë...



Aksident në Selenicë, makina përplasjet me barrierat e rrugës, lëndohet drejtuesja

Një aksident ka ndodhur mbrëmjen e sotme në dalje të fshatit Brataj, në Selenicë. Mësohet se drejtuesja e automjetit ka...

Me sytë katër



16:47

A po eksporton apo jo armë Shqipëria? Ministria e Mbrojtjes me dy versione (VIDEO)

Që pas publikimit të përgjimeve të mikut izraelit të Ramës, Ron Yeffet, me disa shtetas ukrainas që kërkonin të bl...



"Plaka ime s'di pultin e TV dhe jo më e-Albania"/ Korreshi tallet në Komisionin e Ligjeve

21:56



VIDEO/ Batutat e Ramës me Altinin nga Peza: Ky nuk është socialist, por...

23:04



PAMJET/ Zegjine Çausi ndryshon pamje, nuk e njohin Garda dhe gazetarët

21:21



PAMJET/ Burri rreh një grua që në takimin e dytë sepse ajo e refuzoi

20:31



PAPARAZZI



Tension në tapetin e kuq? Reagimi i Nicola Peltz ndaj Brooklyn Beckham bëhet viral

Brooklyn Beckham dhe bashkëshortja e tij, Nicola Peltz, janë bërë sërisht pjesë e vëmendjes mediatike, pas një momenti t...




Megan Thee Stallion flet për ndarjen nga Klay Thompson

21:27



Misteri i James Bond-it të ri po merr fund? Skenaristi zbulon detajin e papritur

20:23



Travis Kelce flet për herë të parë për dasmën me Taylor Swift: "Ishte magjike"

21:24



Cassie Ventura shfaqet për herë të parë në tapetin e kuq pas gjyqit të Diddy-t

18:56



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.